R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 336/1 prot. Tiranë, më 30.01.2026

VENDIM

Nr. 04, datë 30.01.2026

PËR KONTROLLUESIN "SISAL ALBANIA" SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit "*Sisal Albania*" shpk (në vijim, "*Kontrolluesi*"),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 154, datë 02.09.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me numër identifikimi L91611023S, në Tiranë, i cili ka si objekt aktiviteti: "*Konceptimin, krijimin, zhvillimin dhe zbatimin e aplikacioneve softwerike, sistemet e plota të IT dhe platformat IT* etj."

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë "*klientë*", "*punëmarrës*", etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Konstatohet se, në dosjet e personelit të larguar ruhen, ndër të tjera, kopje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore, kopje të letërnjoftimit, jetëshkrim (CV), kopje diplome. Të dhënat e mbledhura për personelin e larguar ruhen nga Kontrolluesi, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit "*Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 11*").

   Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

3. Kontrolluesi ka krijuar në platformën "*Facebook*" dhe "*Instagram*", profile zyrtare, në të cilat pasqyrojnë aktivitete/veprimtari, duke ilustruar nëpërmjet fotografive, të dhënat e subjekteve, "*punonjës*", "*pjesëmarrës*", etj.

   Konstatohet se të dhënat personale të subjekteve janë përpunuar dhe/ose publikuar në rrjetin social "*Facebook*", "*Instagram*" dhe faqen e internetit www.sisal.al, pa marrë paraprakisht pëlqimin e tyre, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe me kriteret për përpunimin e tyre, të parashikuara në nenet 6 dhe 7, të Ligjit, si dhe në mungesë të pëlqimit të kërkuar sipas nenit 8, të po këtij Ligji.

   Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja, sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

   Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive të subjekteve të të dhënave në platforma si "*Facebook*" dhe "*Instagram*" apo në faqen e internetit www.sisal.al, pa marrë paraprakisht "*Pëlqimin*", bie në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

   "*Pëlqim*" është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

4. Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion "*Procedura për menaxhimin e mbrojtjes së të dhënave personale*". Nga verifikimi i përmbajtjes së saj konstatohet se mungojnë elementët formalë të dokumentit (*nënshkrimi, vula etj*.).

   Megjithatë, nga shqyrtimi i saj rezulton se, rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit, të parashikuara në Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*" (në vijim "*Vendimi nr. 6*") dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*") dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

   Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*" dhe përshtatja e dispozitave të saj, në mënyrë të tillë që, të parashikohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, në veçanti të dhënat sensitive, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

5. Kontrolluesi disponon disa politika të miratuara dhe të pa miratuara lidhur me sigurinë e informacionit, konkretisht:

   - Politika e Privatësisë – Furnitorë;
   - Politika e Privatësisë – Kandidatë;
   - Politika e Privatësisë – vizitorë web;
   - PL003_Politika e menaxhimit të sigurisë në zhvillimin dhe blerjen e sistemeve_shqip;
   - PL004_Politika e menaxhimit të sigurisë së informacionit me palët e treta_shqip;
   - PL005_Politika e menaxhimit të klasifikimit të informacionit_shqip;
   - PL012_Korniza e rrezikut kibernetik dhe e kontrollit_shqip;
   - PL019_Politika e enkriptimit dhe maskimit i të dhënave _shqip;
   - PL020_Politika e menaxhimit të backup_shqip;
   - PL021_Politika e menaxhimit të ngurtësimit të sistemeve_shqip;
   - PL022_Politika e menaxhimit të incidenteve të sigurisë_shqip;
   - PL023_Politika e menaxhimit të logeve_shqip;
   - PL031_Politika e menaxhimit të sigurisë në rrjetat kompjuterike_shqip;
   - PL031_Politika e menaxhimit të sigurisë në rrjetat kompjuterike_shqip;
   - PL040_ Politika e menaxhimit të aksesit logjik_shqip;

- PL051_Standardet Globale të Politikës së Përdorimit të Pranueshëm të Informacionit dhe Aseteve Teknologjike – al;
- Systems and profiles – Sistemet e përdorura dhe profilet e aksesit.

Megjithatë, rezulton se politikat i referohen masave të ndërmarra për sigurinë kibernetike (përfshirë dokumentacion të *Flutter Group*), si dhe mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si, "*Dokumentimi i proceseve të politikave të miratuara nga Kontrolluesi*", "*Kontrolli i sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave personale nga një audites i pavarur*", "*Analiza e sigurisë së sistemit të arkivimit*", "*Raport vlerësimi mbi sigurinë në sistemin e arkivimit*", etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Për sa më sipër, rezulton se masat e ndërmarra nga Kontrolluesi janë të pamjaftueshme në raport me veprimtarinë e gjerë që kryen. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, si dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, si dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në Kreun IV, të Udhëzimit nr. 47 dhe nenin 34 të Ligjit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018 të Komisionerit "*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave*

personale dhe mbrojtjes së tyre" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 48*"), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akreditуar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore, të zhvilluar më datë 16.10.2025, paraqiti pretendimet me shkrim mbi konstatimet e procesverbalit, si vijon:

- Lidhur me konstatimet e pikës 2 të procesverbalit të hetimit administrativ, kontrolluesi pretendon se, "*Të dhënat e punëmarrësve, në përputhje me nenin 33 të Kodit të Punës zakonisht ruhen për sa kohë zgjat marrëdhënia e punës. Maksimalisht ruajtja e të dhënave personale bëhet për një periudhe deri ne 6 muaj pas përfundimit të marrëdhënies së punës, në përputhje kjo me të drejtën e padisë që punëmarrësi ka. Përtej këtij afati Sisal nuk ruan të dhëna të punëmarrësve. Dosja e venë në dispozicion Grupit të Inspektimit për shqyrtim gjatë periudhës së hetimit administrativ, i takon një ish-punëmarresi, i cili ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me datë 02.08.2025, pra bie brenda afatit të parashkrimit të të drejtës së padisë sipas nenit 33 të Kodit të Punës...".*

  Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale, për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar (neni 6, pika 5 e Ligjit) dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar, të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm.

  Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se përcaktimi i afateve kohore duhet të jetë i parashikuar konkretisht në akte të brendshme si rregullore/politika, etj. Kontrolluesi duhet të identifikojë rast pas rasti kategoritë e të dhënave që përpunon dhe duhet të përcaktojë afatet e ruajtjes së këtyre të dhënave në aktet e veta të brendshme rregullatore, në përputhje me qëllimin e grumbullimit, apo afate të tjera të përcaktuara në një dispozitë ligjore konkrete.

- Lidhur me konstatimet e pikës 3 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Lidhur me përdorimin e imazheve të punëmarrësve, konfirmojmë se është marrë pëlqimi i tyre, megjithatë kjo praktikë nuk është ende e formalizuar në dokumentacion të shkruar, për shkak të karakterit të ri të iniciativës. Bashkangjitur këtu do të gjeni, draft-in e Deklaratës së Pëlqimit Specifik të përpiluar nga Sisal Albania për të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet e organizuara nga Sisal Albania gjatë*

të cilave parashikohet përpunim i të dhënave personale (imazh, zë etj.) për qëllime të transmetimit të mesazheve nga ana e Punëdhënësit..."

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Kontrolluesi pranon se nuk ka siguruar pëlqimin e subjekteve të të dhënave për përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet publikimit në rrjete sociale apo faqen e internetit. Pëlqimi verbal nuk është bazë ligjore e vlefshme për përpunimin apo publikimin e imazhit. Publikimi i fotografive në rrjetet sociale dhe faqen zyrtare, pa procedurë të formalizuar dhe pa marrë pëlqimin, përbën shkelje të neneve 6, 7 dhe 8 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka detyrimin të marrë masa në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, në respektim të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit, ku parashikohet se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet, vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 7 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e Kontrolluesit për të rikuperuar shkeljet e konstatuara duke vendosur në dispozicion formularët e pëlqimit, por kjo nuk e përjashton atë nga përgjegjësia administrative, në rastin konkret, për shkak se detyrimi duhet të ishte plotësuar paraprakisht nga Kontrolluesi, në përmbushje të detyrimeve të Ligjit.

- Lidhur me konstatimet e pikës 4 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Sisal ka miratuar të gjitha politikat dhe procedurat mbi masat e sigurisë teknike dhe organizative, politika të cilat janë vendosur në dispozicion si dhe janë listuar në pikën 5 si dokumenta të paraqitura nga Kontrolluesi. Konkretisht: Politika e menaxhimit të Sigurisë në zhvillimin dhe blerjen e sistemeve, Politika e menaxhimit të klasifikimit të informacionit etj. Të gjitha Politikat e sipërpërmendura synojnë adresimin dhe marrjen e masave të duhura teknike dhe organizative me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave personale...*"

  Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Kontrolluesi nuk ka dokumentuar nënshkrimin, miratimin, historikun e versioneve apo shpërndarjen e politikave të brendshme. Publikimi/ dhe ose shpërndarja në intranet nuk përbën provë të vlefshme të miratimit ligjor të dokumenteve. Në mungesë të elementëve formalë dhe operacionalë, politikat nuk mund të konsiderohen "*të miratuara*" sipas kërkesave të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47.

  Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, ashtu sikurse citohet dhe nga vetë Kontrolluesi, grupi i politikave i referohet fushës së sigurisë kibernetike dhe sistemeve elektronike. Kontrolluesi, për çdo proces përpunues (në mënyrë manuale apo elektronike) duhet të zbatojë detyrimet e parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit në lidhje me SMSI për mbrojtjen e të dhënave.

- Lidhur me konstatimet e pikës 4 dhe 5 të procesverbalit të hetimit administrativ, kontrolluesi pretendon se, "*Lidhur me nënshkrimin e Rregulloreve dhe Politikave të*

brendshme, konfirmojmë se politikat aprovohen rregullisht nga Administratori i Shoqërisë. Sisal Albania ka në fuqi një proces të mirë-dizenjuar në lidhje me përcaktimin e roleve dhe detyrave sa i takon procesit të vendimmarrjes së miratimit të Politikave apo Procedurave. Të gjitha dokumentet pasi kalojnë procesin e aprovimit sa më sipër përshkruar, proces në të cilin përfshihen të gjitha strukturat sipas fushës së mbuluar nga akti në shqyrtim, publikohen në faqen e intranetit të Shoqërisë, e cila është e aksesueshme nga i gjithë stafi, në çdo kohë..."

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Politikat e paraqitura janë formale, të pjesshme dhe të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e nenit 28 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit. Mungojnë elementët e detyrueshëm si dokumentimi i proceseve, auditimi i pavarur i sigurisë, analiza e arkivimit, testimi i masave etj. Kontrolluesi duhet t'i hartojë politikat në funksion të proceseve përpunuese të tij, përfshirë edhe për të dhënat që përpunohen nëpërmjet proceseve manuale (fizikisht).

Gjithashtu, hartimi i një "*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

- Lidhur me konstatimin se, "*Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete, në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale...",* Kontrolluesi pretendon se*, "Në këtë këndvështrim, konfirmojmë gjithashtu se shoqëria Sisal Albania ka kryer rregullisht trajnime për punëmarrësit lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Materialin e ofruar gjatë trajnimeve, Materialin (draft) të përgatitur për t'u ofruar për të gjithë popullsinë në përputhje me Procedurën e Përpunimit të të Dhënave Personale, aktualisht në proces rishikimi....*"

  Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Kontrolluesi gjatë hetimit administrativ nuk paraqiti prova të kryerjes së trajnimeve për punonjësit që përpunojnë të dhëna personale. Mungojnë regjistrat, listat e pjesëmarrjes, programi i trajnimeve dhe verifikimi i njohurive, në kundërshtim me kërkesat e nenit 34 të Ligjit dhe Kreut IV të Udhëzimit nr. 47. Modulet e trajnimit të depozituara pas zhvillimit të seancës dëgjimore janë të përgjithshme dhe bazohen në detyrimet që parashikohen në GDPR (Rregullorja (BE) 2016/679).

  Gjithashtu, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit, si dhe duhet të kryhen me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve, të cilët

për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 94 të Ligjit, si dhe shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 94 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

"*1. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë, shkeljet e detyrimeve:*

a) të kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas neneve 8, pika 6, e 11, të kapitullit III, të pjesës II të këtij ligji, me përjashtim të nenit 22 të këtij ligji;

2. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë, shkeljet e mëposhtme:

a) moszbatimi i parimeve themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, sipas neneve 6, 7, 8 e 9, të këtij ligji;
b) shkeljet e të drejtave të subjekteve të të dhënave sipas neneve 12–20 të këtij ligji;"

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e masave të nevojshme organizative dhe teknike që Kontrolluesi ka detyrimin të zbatojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, aktet e referuara nuk prodhojnë efekt juridik për qëllime të zbatimit të Ligjit.

Në rrethanat e shqyrtimit të kësaj çështje, Zyra e Komisionerit evidenton shkallën e bashkëpunimit nga ana e Kontrolluesit. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë pasqyrën financiare të Kontrolluesit të deklaruar në regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe rëndësinë e proceseve përpunuese.

Sa më sipër, mbështetur në dispozitat e Udhëzimit nr. 06, datë 16.07.2025, "*Për miratimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative*", veçanërisht në pikat 7 dhe 8, të Seksionit 2.3, të Kapitullit 2 dhe të Kapitullit 4, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe transparente masën e sanksionit administrativ ndaj Kontrolluesit, sipas përcaktimeve të neneve 93 dhe 94 të Ligjit, duke u bazuar në kufijtë minimalë të përllogaritjes.

Komisioneri vlerëson faktin se, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 8, 28, 34, 81-84, pikës 1 të nenit 87, nenit 93, shkronjës "a" të pikës 1 dhe shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 94, si dhe nenit 95 të Ligjit, dhe të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*", Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën **4.040.000** (katër milion e dyzetë mijë) Lekë, për shkelje të neneve 6, 7 dhe 8 të Ligjit;

2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën **1.515.000** (një milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të nenit 28 të Ligjit;

3. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;

4. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit;

5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores *"Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"*, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;

6. Kontrolluesi, të marrë masa lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre, sipas parashikimeve të përcaktuara në shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 1, të nenit 34 të Ligjit;

7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që

kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale; [1]

8. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48; [2]

9. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

i. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 3 më sipër;
ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 më sipër;
iii. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 6 dhe 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

10. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;

11. Vendimi për gjobë përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga kundërvajtësi (Kontrolluesi), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Për ekzekutimin e gjobës ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor;

12. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 30.01.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

[1] Udhëzimi nr. 47 dhe Udhëzimi nr. 48 janë shfuqizuar me Udhëzimin nr. 08, datë 20.11.2025 "*Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues*";
[2] Detyrimet e parashikuara në Udhëzimin nr. 47 dhe nenin 5, të udhëzimit nr. 48, vijojnë sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 9, datë 20.11.2025 "*Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale*".